



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:105699

Datë: 28.05.2024

Numri i dokumentit: 05747184

KPPP.nr.201/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike SH.A., me NRB:70606119, me seli në Prishtinë, kundër debitorit "Euro Keni" SH.P.K., me NRB:70636875, me seli në Mitrovicë, rruga "Mbretëresha Teutë", duke vendosur lidhur me propozimin e kreditorit për përmbartim, jashtë seancës me datë 28.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Hapet konflikti i kompetencës në mes të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike dhe Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Departamenti i Përgjithshëm, për të vendosur në çështjen juridike përmbartimore në mes të kreditorit Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike SH.A., dhe debitorit "Euro Keni" SH.P.K..
- II. Për të vendosur lidhur me konfliktin e kompetencës lënda i dërgohet Gjykatës Supreme të Kosovës.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë, Departamenti i Përgjithshëm, me Aktvendimin CP.nr.256/2016, të datës 26.07.2023, është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje përmbartimore, ndërsa lëndën ia ka dërguar Gjykatës Komerciale, Dhomave të Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike.

Dhomat e Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjatë shqyrtimit paraprak të lëndës gjeti se çështja e cila është objekt i saj përfaqëson çështje për vendosjen e së cilës kjo gjykatë nuk ka kompetencë lëndore, por që për vendosjen e kësaj çështje është kompetente Gjykata Themelore në Mitrovicë, Departamenti i Përgjithshëm, për arsye si në vijim:

Kompetenca e Gjykatës Komerciale në çështjet përmbareme është e rregulluar me nenin 13 të Ligjit nr. 08/L-15 për Gjykatën Komerciale, me të cilin në paragrafin 1, pika 1.2 përcaktohet se: *“Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.2. : të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbareme, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate.”*

Ndërsa, mjetet juridike në procedure përmbareme, konform ligjit të aplikueshëm, Ligji nr. 04/l-139 për Procedurën Përmbareme (tutje: LPP) janë të përcaktuara në nenin 67, sipas të cilit në paragrafin 1 përcaktohet se: *“Në procedurën përmbareme, mjetet e rregullta të goditjes janë: 1.1. Prapësimi dhe 1.2. Ankesa,”* ndërsa me nenin 68 të po të njëjtit ligj, përcaktohen Mjetet e jashtëzakonshme juridike, ku decidivisht përcaktohet se: *“1. Nuk është i lejuar revizioni dhe përsëritja e procedurës në procedurën përmbareme. 2. Kthimi në gjendjen e mëparshme është i lejuar vetëm në rastet e mos ruajtjes së afateve për paraqitjen e prapësimit dhe ankesës kundër vendimeve të përmbareme për përmbaremin me dhunë.”*

Në rastin konkret, lënda e cila është transferuar në këtë gjykatë ka për objekt caktimin dhe zbatimin e përmbaremit sipas propozimit për përmbareme të kreditorit, ndërsa nuk ka për objekt shqyrtimi mjetet juridike në procedure përmbareme të përcaktuara në nenin 67 dhe 68 të LPP-së, ashtu që në kuptim të dispozitave nga neni 13, pika 1.2 të Ligjit për Gjykatën Komerciale, kjo gjykatë nuk ka kompetencë për vendosje në këtë çështje përmbareme.

Andaj, duke marrë parasysh faktin se objekt në këtë çështje përmbareme është caktimi dhe zbatimi i përmbaremit nga gjykata si organ përmbareme sipas propozimit për përmbareme të kreditorit, ndërsa në shkresa të lëndës nuk ka ndonjë mjet juridik për të cilin Gjykata Komerciale do të ishte e kompetencës për të vendosur, kjo gjykatë vlerëson se pikërisht Gjykata Themelore në Mitrovicë, Departamenti i Përgjithshëm është gjykatë kompetente për vendosje në këtë çështje përmbareme, kjo në mbështetje edhe të dispozitave nga neni 5 i LPP-së.

Nga sa më sipër, në kuptim të nenit 24 dhe 25.2 të Ligjit për procedurën kontestimore, lidhur me nenin 17 të Ligjit për procedurën përmbarimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.201/24, datë 28.05.2024

Gjyqtarja  
Verona Dibra

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.